



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 23.9.2024

Lënda: Bisedimet përfundimtare të Komisionerit Publik, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në çështjen ankim kundër vendimit nr. 693, datë 10.8.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Saimir Hysa

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Drejtuar: Kolegjit të Posaçëm të Apelit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor, në referencë të nenit 302 dhe 303 të Kodit të Procedurës Civile, pasi u shqyrtuan dhe iu nënshtuan debatit gjyqësor të gjitha kërkimet dhe prapësimet e palëve, si dhe provat e administruara në kuadër të këtij gjykimi, Komisioneri Publik, për secilin shkak, në mënyrë të përmbledhur vlerëson se:

I. Për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale

A. Lidhur me kallëzimin penal nr. *, me datë regjistrimi **.6.2022**

1. Komisioneri Publik konstaton se, lidhur me këtë shkak ankimi, subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e depozituara në seancën e datës 16.9.2024, ndër të tjera, ka prapësuar se: [...]Unë asnjë nga dokumentet që citon Gjykata nuk e kam patur në dispozicion, pasi nuk janë sjellë nga kallëzuesi bashkë me kallëzimin. Historinë e infektimit të fëmijës të kallëzuesve, me HIV, unë e kam mësuar kur është sjellë vendimi që shfuqizonte vendimin tim për mosfillimin e procedimit...Ky procedim (nr.**, regjistruar në datën **.6.2023), ka qenë dhe është dhe sot në hetim, dhe për këtë shkak KPK, në zbatim të kapitullit/Nenit E/2, të Kushtetutës të R.Sh...vendimin njehsues 33/2021 të KPA-së, ka vlerësuar se nuk ka kompetencë për trajtimin e kësaj çështje [...].

1.1 Subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë shkak ankimi ka paraqitur në cilësinë e provës shkresën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, nr.*** prot. ***, ***, datë **.9.2024, në të cilën, ndër të tjera, referohet se: [...]

*Procedimi penal nr. ***, viti 2023, regjistruar për veprën penale “Vjedhja” dhe “Mjekim i pakujdesshëm”, parashikuar nga nenet 134 dhe 96 të K. Penal, pa emër autori të regjistruar në regjistrin e njoftimit të veprave penale, vijon të jetë ende në fazë hetimi [...].*

1.2 Sa më sipër, Komisioneri Publik, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, në analizë të akteve të administruara, si dhe referuar prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, vlerëson se edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e shkaqeve të ankimit.

1.3 Po ashtu Komisioneri Publik, pa kaluar në përsëritje, duke iu qëndruar të gjitha shkaqeve të ankimit të datës 31.10.2023, lidhur me kallëzimin penal nr. ***/2022, të trajtuara gjerësisht dhe në parashtrimet e seancës të datës 16.9.2023, lidhur me rrethanat konkrete të aplikimit të nenit E/2 të aneksit të Kushtetutës, në konsideratë dhe të jurisprudencës së Kolegjit, konstaton se:

1.3.1 Nga aktet rezulton se vendimi i marrë nga subjekti i rivlerësimit është bërë objekt kontrolli gjyqësor në Gjykatën e Apelit dhe, tashmë, është sërish në fazë hetimi, si rezultat i ankimit të ushtruar nga subjekti i rivlerësimit/organi i akuzës, kundër vendimit nr. *** Regj. Them., datë **.10.2022, të Gjyqtarit të hetimeve paraprake në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor. Nga ana procedurale, në rrethanat konkrete, për efekt të nenit E/2 të aneksit të Kushtetutës, në vlerësimin e Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit ka përfunduar procesin e shqyrtimit të kallëzimit të analizuar, proces procedural i veçantë, që gjen rregullim të posaçëm ligjor, në momentin kur është shprehur me vendimin për mosfillimin e procedimit penal, vendim ky i cili është ankimuar nga pala e interesuar.

1.4 Referuar sa ka pretenduar subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ në Komision apo gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, mbeten të provuara vonesat e mëtejshme në hetimin e mëtejshëm, vonesa këto të lidhura me ankimimin në Gjykatën e Apelit, në kushtet kur *iteri* i infektimit të foshnjës me HIV, apo pretendimet e kallëzuesve kishin gjetur pasqyrimin në vendimin përkatës nga Gjykata e Shkallës së Parë, ashtu sikurse parashtron dhe subjekti i rivlerësimit.

1.4.1 Në përmbledhje të sa më sipër, Komisioneri Publik, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, vëren se në kallëzimin penal të analizuar, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e konstatimit të shfaqjes së mangësive në kuadër të aftësive për të ndërmarrë hetimin dhe mbledhur provat e kërkuara me ligj, duke passjellë vonesa në hetimin e çështjes, pa ia nënshtruar një hetimi të gjithanshëm dhe interpretimi të drejtë të ligjit, që do të lejonte përcaktimin e fajësisë së mundshme të subjekteve të përfshirë.

1.4.2 Këto rrethana, në vlerësimin e Komisionerit Publik duhen parë edhe në drejtim të standardeve të përcaktuar nga indikatorët e nenit 73 dhe 74 të ligjit nr. 96/2016, si një tregues i aftësisë profesionale dhe organizative, dhe mënyrës se si subjekti i rivlerësimit ka përballuar ngarkesën, në kuadër të rrethanave ligjore dhe faktike konkrete.

2. Lidhur me kallëzim penal të shtetasit *, ***,**

2.1 Komisioneri Publik konstaton se, në funksion të këtij shkak ankimi, subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e depozituara në seancën e datës 16.9.2024, ndër të tjera, ka prapësuar se: [...] *Në dosje gjendet shkresa përcjellëse e nënshkruar nga Drejtuesi i Prokurorisë me objekt “Njoftim vendim pushimi”, drejtuar ***, ***, në adresën e dhënë*

prej tij...Gjatë hetimit kam paraqitur një kopje të kësaj shkrese, me përpilimin e së cilës mbaron detyrimi ligjor për njoftimin e palëve, pasi veprimet e mëtejshme kryhen nga Sekretaria e Prokurorisë, një kopje e librit të protokollit/dorëzimit ku rezulton se në numrin *** prot., datë *.10.2009, figuron i regjistruar njoftimi që i është dërguar ***.***... Në vendimin tim nuk kam bërë këtë pohim, por kam konstatuar se “Pyetja e tij (shtetasi ***, ***), nuk është bërë e mundur pasi ky shtetas prej shumë vitesh ndodhet jashtë shteti”. KP më citon në mënyrë të gabuar duke ndryshuar thelbin e deklaramentit tim, pasi unë nuk kam thënë se ky person nuk mund të hetohet për këtë shkak, por vetëm se “nuk është bërë e mundur pyetja e tij për këtë shkak [...]”.

2.2 Subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë shkak ankimi, referon Udhëzimin nr.241, datë 21.11.2005, “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale” të Prokurorit të Përgjithshëm.

2.3 Sa më sipër, Komisioneri Publik, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, në analizë të akteve të administruara, si dhe referuar prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, vlerëson se edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e shkaqeve të ankimit. Komisioneri Publik, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, dhe jurisprudencës së Kolegjit¹, vlerëson se qëndrimi i shprehur nga subjekti i rivlerësimit në parashtrimet e tij, se ky veprim është përgjegjësi e administratës së Prokurorisë, nuk mund të përbëjë justifikim më së paku për mungesën e ushtrimit të një kontrolli nga ana e tij lidhur me përmbushjen e një detyrim ligjor, që lidhet me çështje të hetuara prej tij, respektimi i të cilit lidhet me ushtrimin eventualisht e të drejtave procedurale nga subjektet përkatëse.

2.4 Komisioneri Publik, në ankimin e datës 31.10.2023, ka referuar arsyetimin e subjektit të rivlerësimit në vendimin për pushimin e çështjes, ku, ndër të tjera, shprehet se: [...] Pyetja e tij (shtetasit ***, ***), nuk është bërë e mundur, pasi personi prej shumë vitesh ndodhet jashtë shtetit...Duke patur parasysh qëndrimin e ***, ***, dhe vajzave të saj se ato nuk kanë patur dijeni për këto veprime të kryera prej ***,...dhe pamundësia e pyetjes të ***, ***, e bën të pamundur vërtetimin e këtij fakti [...].

2.5 Sa më sipër, Komisioneri Publik, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, në analizë të akteve të administruara, si dhe referuar prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, depozituar në seancën e datës 16.9.2024, vlerëson se në përfundim të këtij procesi, për sa trajtuar gjerësisht në ankimin e datës 31.10.2023 dhe parashtrimet e Komisionerit Publik të datës 16.9.2024, subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e barrës së provës.

2.6 Në kallëzimin penal të analizuar, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e konstatimit të shfaqjes së mangësive në kuadër të aftësisë për të kryer me efekt procedurat hetimore, brenda afateve të përcaktuara, të mbledhjes së provave të nevojshme, duke përfshirë dhe mungesën e mbikëqyrjes së dërgimit pa vonesë të akteve të nevojshme të njoftimit, referuar indikatorëve të përcaktuar nga neni 74/4 i ligjit nr. 96/2016.

3. Lidhur me denoncimin e shtetasit *, ***,**

3.1 Komisioneri Publik konstaton se, në funksion të këtij shkak ankimi, subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e depozituara në seancën e datës 16.09.2024, ndër të tjera, ka prapësuar se: [...] Më duhet dhe në këtë rast të citoj edhe njëherë nenin E/2 të Kushtetutës së

¹ Referohuni arsyetimit të Kolegjit në vendimin (JR) nr. 19/2021, prg. 31.2.

Shqipërisë..., pasi procedimi penal nr.*** i vitit 2021 është ende në fazën e hetimit paraprak...Për këtë seancë (**.11.2021) unë nuk kam patur dijeni dhe sipas p-v të seancës Gjykata ka konstatuar se “u thirr nuk u paraqit prokurori ***, ***, duke caktuar seancën e radhës në *.1.2022... Në datë *.5.2022, shtetasi ***, ***, ka depozituar në Sekretarinë e Gjykatës të Rrethit Gjyqësor Tiranë një kërkesë për shtyrjen e seancës të datës *.5.2022, pasi kishte angazhime personale. Pasi jam vënë në dijeni nga Sekretaria Gjyqësore për këtë kërkesë, unë nuk jam paraqitur në seancë duke e konsideruar të panevojshme prezencën time... Seanca e radhës është caktuar në *.7.2022, ku unë nuk kam marrë pjesë dhe Gjykata ka vazhduar gjykimin duke shpallur dhe vendimin për kthimin e akteve... Në total për shqyrtimin e kësaj kërkesë janë zhvilluar *.11.2021; *.1.2022; *.4.2022; *.5.2022; *.6.2022; *.7.2022. .., Nga p-v rezulton se dy seancat e zhvilluara nga gjyqtari ***, ***, në datë *.11.2021; *.1.2022, unë nuk kam patur dijeni pasi njoftimet janë bërë për prokurorin e mëparshëm. E vetmja seancë që kam munguar ka qenë ajo e datës *.6.2022, nuk jam në gjendje të shpjegoj se për çfarë arsye, e cila gjithsesi nuk është bërë shkak për të shtyrë seancën... Lidhur me rastin tjetër kam qenë dhe jam i bindur se vendimi im për mosfillimin e procedimit ka qenë marrë në përputhje të plotë me ligjin dhe shpreh plotësisht bindjen time të brendshme dhe Gjykata ka gabuar në shfuqizimin e tij[...].

3.2 Subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë shkak ankimi, ka paraqitur në cilësinë e provës:

(1) Shkresë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë, nr.*** prot. ***, ***, datë *.9.2024, në të cilën, ndër të tjera, referohet se: [...] *Procedimi penal nr.***, viti 2020, regjistruar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i K. Penal, pa emër autori të regjistruar në Regjistrin e njoftimit të veprave penale, vijon të jetë ende në fazë hetimi [...].*

(2) Vendim, datë *.3.2019, për mosfillimin e procedimit, për kallëzimin penal nr. ***/2019, referuar për veprën penale të “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i K. Penal.

(3) Shkresë nr. *** prot., datë ...4².2019, “Njoftohet vendimi për mosfillimin e procedimit nr. ***/2019”, drejtuar shtetasit ***, ***.

(4) Vendim, datë *.5.2022, për mosfillimin e procedimit, për kallëzimin penal nr. ***/2022, referuar për veprën penale të “Ekspertim i rremë”, të parashikuar nga neni 309 i K. Penal.

(5) Shkresë nr. *** prot., datë *.6.2022³, “Njoftohet vendimi për mosfillimin e procedimit”, drejtuar shtetasit ***, ***.

3.3 Sa më sipër, Komisioneri Publik, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, në analizë të akteve të administruara, si dhe referuar prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, vlerëson se, edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e shkaqeve të ankimit mbi shkaqet e arsyeshme lidhur me mungesat në seancat e trajtuara dhe mbi mungesën e veprimeve hetimore, gjatë kohës që çështja është trajtuar nga subjekti i rivlerësimit.

² Data nuk është e dukshme, ndërsa muaji duket i korigjuar.

³ Data dhe muaji nuk janë lehtësisht të dukshme.

3.4 Po ashtu, Komisioneri Publik, pa kaluar në përsëritje, duke iu qëndruar të gjitha shkaqeve të ankimit të datës 31.10.2023, lidhur me denoncimin e shtetasit ***, ***, të trajtuar gjerësisht dhe në parashtrimet e seancës të datës 16.9.2023, lidhur me rrethanat konkrete të aplikimit të nenit E/2 të aneksit të Kushtetutës, në konsideratë dhe të jurisprudencës së Kolegjit, konstaton se mbetet e provuar se gjetjet e rezultuara nga hetimi administrativ lidhen kryesisht me mosveprimet dhe mungesën e efikasitetit në ushtrimin e ndjekjes penale prej subjektit të rivlerësimit gjatë periudhës korrik 2021 - korrik 2022. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.***/** Regj. Them., datë **.7.2022 (dt. regj. **.5.2021), ka vendosur kthimin e akteve Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, ndër të tjera, pasi organi i Prokurorisë nuk ka hetuar në lidhje me kallëzimin për *dokument të falsifikuar*, i vetmi moment procedural, për të cilin mund të konsiderohet se çështja është akoma në shqyrtim.

3.5 Sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se gjetjet e konstatuara në rezultatet e hetimit shtesë lidhur me këtë procedim penal duhet t'i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, së bashku me gjetjet e tjera, në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.

4. Lidhur me procedimin penal të ndarë nga çështja *-*****

4.1 Komisioneri Publik konstaton se në funksion të këtij shkaku ankimi, subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e depozituara në seancën e datës 16.9.2024, ndër të tjera, ka prapësuar se: *[...] Në momentin që unë kam marrë për veprim këtë dosje ishin kryer hetime të shumta lidhur edhe më këtë fakt, mjafton të shihet volumi i dosjes. Veprimet e kryera nga prokurori paraardhës natyrisht kanë të njëjtën vlerë procedurale, por edhe si prova për prokurorin që vazhdon hetimin dhe nuk ka nevojë që të ripërsëriten... Cilësimi ligjor i veprës penale është atribut i prokurorit dhe unë, në rastin konkret, duke qenë se personat e dyshuar nuk ishin persona me funksione shtetërore apo publike, kam vlerësuar se këta persona nuk janë subjekt i prg. 3, të neni 186 të K. Penal, si persona që kanë për detyrë të lëshojnë dokumentin, ndaj e kam kualifikuar rastin sipas paragrafit të dytë të nenit 186 të K. Penal, në bashkëpunim...Po kështu, edhe sa i takon kohës së marrjes të vendimit, e pranoj se çështja mund të ishte përfunduar më shpejt, por kjo për shkak të ngarkesës së madhe të punës dhe faktit se materiali është shumë voluminoz, 12 volume. Këtë vendim mund ta kishin marrë edhe vetë prokurorët që kanë bërë veçimin e çështjes, pasi që në momentin kur është bërë ndarja kishin kaluar afatet e parashkrimit për veprën penale të parashikuar nga neni 186/2 i K. Penal. Lidhur me shkakun se nuk ka marrë vendim për zgjatje të afatit të hetimit, ky konstatim nuk qëndron, pasi në rastin konkret, nuk është përpiluar asnjë urdhër për regjistrimin e emrit të personit në Regjistrin njoftimeve të veprave penale si autor të ndonjë vepre penale [...].*

4.2 Subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë shkak ankimi, gjatë parashtrimeve në seancën e datës 16.9.2024, ka referuar *udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, "Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale"* të Prokurorit të Përgjithshëm.

4.3 Sa më sipër, Komisioneri Publik, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk dha shpjegime bindëse për çështjet e ngritura nga Komisioni në vendimin nr.696/2023 dhe në shkaqet e ankimit, si dhe pretendimet e tij nuk gjejnë mbështetje në rrethanat dhe aktet e paraqitura nga subjekti.

4.4 Komisioneri Publik, pa kaluar në përsëritje, duke iu qëndruar të gjitha shkaqeve të ankimit të datës 31.10.2023, duke vlerësuar kompleksitetin e kësaj çështje, parashtruar dhe nga subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së dhe jurisprudencës së Kolegjit, vlerëson se gjetjet e konstatuara nga Komisioni, në rezultatet e hetimit shtesë lidhur me këtë procedim penal, nuk duhen transferuar pranë ILD-së për inspektim, por, së bashku me gjetjet e tjera në kontrollin e aftësive profesionale, duhen vlerësuar në kuadër të procesit të rivlerësimit, në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, referuar gjetjeve të konstatuara në rezultatet e hetimit në Komision, ashtu dhe në shkaqet e ankimit.

5. Lidhur me denoncimin⁴ e shtetasit *. ***.**

5.1 Komisioneri Publik konstaton se, në funksion të këtij shkak ankimi, subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e depozituara në seancën e datës 16.9.2024, ndër të tjera, ka prapësuar se: [...] *Lidhur me sa kërkohet për zgjatjen e hetimeve mbi tre muaj, si dhe dy rastet e tjera sipërpërmendur, për të mos ripërsëritur, kam të njëjtin shpjegim, se nuk kam patur arsye, pasi nuk ishte regjistruar emri i autorit të veprës penale, pasi hetimet kryheshin së pari për të provuar nëse ekzistonte vepra penale apo jo... Në datën **.7.2010, me vendimin nr.***, akti, Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë ka vendosur shfuqizimin e vendimit të pushimit, duke lënë si detyrë pyetjen e shtetasve ***. dhe ***. ***.; ***. ***. dhe ***. ***., si dhe ripyetjen e shtetasve ***.***... Pas mbërritjes së vendimit të sipërcituar janë kryer veprime të tjera hetimore...në asnjë rast nuk u provuan pretendimet e kallëzuesit ***. ***., për një ngjarje automobilistike, por të gjitha provat të çonin në konkluzionin se rrëzimi i ***. ***. ishte aksidental. Shkaku i pushimit të çështjes nuk ka qenë fakti se ***. ***. ndodhej jashtë shtetit, por se: “Në tërësinë e fakteve të mbledhura nuk ka asnjë provë ligjore që të vërtetojë faktin së dëmtimet e ***. ***. janë shkaktuar nga një aksident automobilistik [...].*

5.2 Subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë shkak ankimi, gjatë parashtrimeve në seancën e datës 16.9.2024, ka referuar *udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale”* të Prokurorit të Përgjithshëm.

5.3 Sa më sipër, Komisioneri Publik, pa kaluar në përsëritje, duke iu qëndruar të gjitha shkaqeve të ankimit të datës 31.10.2023, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, vlerëson se rrethanat e rastit konkret mbeten të njëjta si gjatë hetimit administrativ në Komision dhe duhen vlerësuar në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, së bashku me gjetjet e tjera në kriterin e aftësive profesionale, lidhur me efikasitetin e veprimeve hetimore sipas nenit 74/4 të ligjit nr. 96/2016, për sa trajtuar gjerësisht dhe në shkaqet e ankimit të datës 31.10.2023.

6. Lidhur me denoncimin⁵ e shtetasit *. ***.**

6.1 Komisioneri Publik konstaton se, në funksion të këtij shkak ankimi, subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e depozituara në seancën e datës 16.9.2024, ndër të tjera, ka prapësuar se: [...] *Së pari, në mënyrë të gabuar, shtetasi ***. ***. cilësohet si “kallëzues”, në një kohë që ai nuk e gëzon këtë cilësi, pasi kallëzimi nr.*** është regjistruar mbi bazën e*

⁴ Nr. *** prot., datë **.4.2019, nr. ***, datë **.4.2019 dhe nr. ***, datë **.6.2019, administruar në dosjen e Komisionit.

⁵ Nr. *** prot., datë **.2.2020, nr. *** prot., datë **.2.2020, nr. *** prot., datë **.7.2021 dhe nr. ***, datë **.7.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

referimit të ardhur nga policia gjyqësore në DVP Tiranë dhe unë nuk kam patur në hetim asnjë kallëzim të bërë prej ***. ***, nuk gëzon asnjë cilësi që unë t'i komunikoj atij vendimin... Përveç kallëzimit nr. ***/2018, me kallëzues ***.***., kallëzimi nr. ***/2019, me kallëzues ***. ***, po për të njëjtin fakt ka referuar seksioni kundër pastrimit të parave në DVP Tiranë kallëzimin nr. ***/2020. Në dukje është referim i policisë gjyqësore, por përsëri ky referim është iniciuar nga ***. ***, e cila është ankuar në një platformë online të K. M... Pra, në thelb nuk jemi para referimit të një fakti penal që policia gjyqësore e ka konstatuar në kuadër të veprimtarisë hetimore-informative të saj, por para një kallëzimi "de facto" të *** ***, kryer për të tretën herë, për të njëjtin fakt, pasi e kishte ezauruar dy herë më parë të drejtën për të bërë kallëzim... Sado të ndryshohet emërtimi apo cilësimi ligjor i faktit dhe pavarësisht se nga cili vjen, qytetar/polici gjyqësore/institucion shtetëror, fakti penal mbetet po ai dhe kallëzimet e ***. dhe ***. ***. janë po të njëjta dhe parimi i "gjësë së gjykuar", e ndalon nisjen e hetimit...nga verifikimi i bërë më rezulton se ky kallëzim është tërhequr prej meje në datën **.1.2019 dhe vetëm pas 4 ditësh kam marrë vendimin për mosfillimin [...].

6.2 Subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë shkak ankimi, gjatë parashtrimeve në seancën e datës 16.9.2024, ka paraqitur:

(1) Shkresë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë, nr.*** prot. ***. ***, datë **.9.2024, në të cilën, ndër të tjera, referohet se: [...] Lidhur me informacionin e kërkuar, ju bëjmë me dije se pas verifikimeve të kryera në regjistrin fizik të njoftim-kallëzimit të veprave penale dhe i mosfillimeve rezulton se kallëzimi penal me nr.***, i regjistruar me datë **.12.2019, të jetë marrë kundrejt nënshkrimit nga prokurori Saimir Hysa me datë **.1.2020 dhe marrë vendim për mosfillimin e procedimit penal me datë **.1.2020. Bashkëlidhur po ju vë në dispozicion kopje të njehsuar me origjinalin të fletës së regjistrit [...].

(2) Aktet e listuara nga numri 1-9, në procesverbalin për dorëzimin e dokumenteve, administruar në cilësinë e provës nga Kolegji, në seancën e datës 16.9.2024.

6.3 Komisioneri Publik, sa më sipër, vëren se, në konsideratë të shkresës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë, nr.*** prot. ***. ***, datë **.9.2024, duket se subjekti i rivlerësimit nuk rezulton në vonesë në vendimin e mosfillimit të procedimit penal, referuar si datë e fillimit të afateve momenti kur kallëzimi është shpërndarë dhe marrë në dorëzim nga subjekti më datë **.1.2020.

6.4 Komisioneri Publik, pa kaluar në përsëritje, duke iu qëndruar të gjitha shkaqeve të ankimit të datës 31.10.2023, në konsideratë dhe të Rekomandimit të ONM-së, vlerëson se prapësimet e subjektit nuk provojnë të kundërtën e rezultateve të hetimit administrativ të Komisionit për rastin konkret, si dhe shkaqeve të ankimit.

6.5 Në këto rrethana, Komisioneri Publik, ndryshe nga sa ka vlerësuar Komisioni, duke iu qëndruar shkaqeve të ankimit mbi rastin konkret, vlerëson se gjetjet e konstatuara në rezultatet e hetimit shtesë lidhur me këtë procedim penal janë të tilla që nuk duhet të ishin transferuar pranë organit kompetent për inspektim, por së bashku me gjetjet e tjera në kontrollin e aftësive profesionale, duhen vlerësuar nga Kolegji në kuadër të procesit të rivlerësimit, në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.

7. Mbi gjetjet lidhur me fashikullin hetimor të procedimit penal nr. *, viti 2005**

7.1 Komisioneri Publik konstaton se, në funksion të këtij shkaku ankimi, subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e depozituara në seancën e datës 16.9.2024, ndër të tjera, ka prapësuar se: [...] *Nga kërkimi që kam unë vetë kam bërë rezulton se kjo dosje është dorëzuar nga sekretaria në arkivën e Prokurorisë dhe nuk është bërë e mundur të gjendej më parë, pasi në procesverbal të dorëzimit ka një gabim material tek numri i procedimit, që është shënuar 2899 dhe jo ***. Pas këtij saktësimi, dosja është gjetur dhe unë do jua vë në dispozicionin tuaj [...].*

(1) Subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë shkak ankimi, gjatë parashtrimeve në seancën e datës 16.9.2024, ka paraqitur disa akte nga dosja nr. 2899, me datë regjistrimi **.9.2005, si dhe vendim pushimi datë **.11.2005, që bën fjalë për veprën penale “*të pengimit të ekzekutimit të vendimit të Gjykatës*”, parashikuar nga neni 320 i K. Penal, të listuara me numër 10-11, procesverbalin për dorëzimin e dokumenteve, administruar në cilësinë e provës nga Kolegji, në seancën e datës 16.9.2024.

7.2 Komisioneri Publik, duke nënvizuar se në ankim për subjektin konkret të rivlerësimit ngrihej vetëm nevoja për të hetuar lidhur me ekzistencën dhe vendndodhjen e fashikullit konkret të organit të Prokurorisë, vëren se aktet e depozituara nga subjekti kanë në referencë numra të ndryshëm të procedimit penal, ku dosja mban numrin 2899, vendimi i pushimit i datës **.11.2005, i referohet akteve të procedimit penal nr. ***, ndërsa në përmbajtje ky vendim i referohet procedimit penal nr. ***, parashikuar nga neni 320 i K. Penal. Aktet janë fotokopje të vëna në dispozicion nga vetë subjekti i rivlerësimit, dhe nuk janë lëshuar nga Zyra e Arkivit e Institucionit.

B. Lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë

8. Apartament banimi, me sipërfaqe 41 m², ndodhur në *, Kavajë**

8.1 Lidhur me këtë pasuri, Komisioneri Publik, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, vlerëson se, dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, mbeti e provuar se vlera e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, si kontribut në blerjen e kësaj pasurie, në shumën 200.000 lekë, nuk korrespondon me pjesën takuese sipas kontratës së shitblerjes⁶. Nëse pagesa e kryer nga subjekti për këtë pasuri do të llogaritej në vlerën 466.667 lekë⁷ ose eventualisht në vlerën 700.000 lekë,⁸ atëherë subjekti do të rezultonte me mungesë burimesh të ligjshme.

8.2 Edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj nuk është paraqitur dokumentacion provues për të dokumentuar marrëdhënien e shërbimit, si dhe shumën që do përfitonte nga ofrimi i këtij shërbimi personi tjetër i lidhur, si rezultat shpjegimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me kontributin e tij për blerjen e kësaj pasurie konstatohen se mbeten në nivel deklarativ dhe kontradiktor me parashikimet në kontratën e shitblerjes së kësaj pasurie, të datës **.9.2005.

⁶ Referuar kontratës së shitblerjes nr. *** rep. dhe nr. ***/* kol., datë **.9.2005, pjesa takuese e subjektit të rivlerësimit është 1/3.

⁷ Vlera 466.667 lekë korrespondon me 1/3 e vlerës së apartamentit sipas kontratës së shitjes, titull pronësie.

⁸ Vlera 700.000 lekë korrespondon me 50% të vlerës së kontratës së shitjes referuar pjesës takuese të subjektit sipas kartelës së pasurisë, lëshuar pas regjistrimit të titullit të pronësisë.

9. Apartament me sip. 71,2 m², ndodhur në rrugën “* **”, Tiranë**

9.1 Lidhur me burimet e krijimit të pasurisë *apartament* me sip. 71,2 m², i ndodhur në rrugën “***. ***.”, Tiranë, Komisioneri Publik vëren se, edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion⁹ përfitimin faktik dhe as ligjshmërinë e të ardhurave të realizuara nga personi i lidhur nga punësimi pranë “***” sh.p.k., dhe Institutit të Politikave Efektive Publike, në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës dhe, si rezultat, nuk provoi mbulimin plotësisht me burime të ligjshme të shumës 4.000 euro, që ka shërbyer si burim krijimi për apartamentin me sipërfaqe 71.2 m², në Tiranë¹⁰.

9.2 Në të njëjtat kushtet provueshmërie konstatohet edhe transaksioni i dhënies së huas, në shumën 15.000 euro, në formën *cash* nga personi tjetër i lidhur, konstatime këto që mbeten për t’ u marrë në konsideratë nga Kolegji, në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.

10. Automjet tip “Renault Megane”, me targë AA***

10.1 Komisioneri Publik, lidhur me pasurinë *automjet tip “Renault Megane”, me targë AA****, vlerëson se, dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, mbeti e provuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore dhe as në Deklaratën “Vetting” huan e marrë nga vëllai i tij, si burim krijimi për këtë pasuri, nuk arriti të dokumentojë këtë transaksion, si dhe nuk provoi të kundërtën lidhur me pamjaftueshmërinë e konstatuar nga Komisioni lidhur me këtë pasuri në vlerën -706.720 lekë.

11. Lidhur me ekzistencën e ndonjë konflikti të mundshëm interesi midis subjektit të rivlerësimit, për shkak të ushtrimit të funksionit të tij, dhe shoqërisë ndërtimore “* **”**

11.1 Komisioneri Publik konstaton se, në funksion të këtij shkak ankimi, subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e depozituara në seancën e datës 16.9.2024, ndër të tjera, ka prapësuar se: [...] *Lidhur me këtë shkak ankimi, mua nuk më është vënë në dispozicion “shkresa me shkrim dore që citon KP, por besoj se bëhet fjalë për kërkesën që unë kam bërë në sekretarinë e Prokurorisë së Tiranës, për pajisjen me vërtetim sipas kërkesës së KPK... Rezulton se ky kallëzim është regjistruar mbi bazën e referimit të ardhur nga policia gjyqësore në Komisaratin e Policisë nr.2, Tiranë, ku shtetasi ***. ***. ka bërë një kallëzim se, në datën **.11.2008, është goditur me grushte në një lokal nga shtetasi ***. ***., duke pësuar dëmtime fizike [...].*

11.2 Subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë shkak ankimi, gjatë parashtrimeve në seancën e datës 16.9.2024, ka paraqitur disa akte të kallëzimit penal nr. ***, të vitit 2008 (14 fletë), të listuar me numër rendor 13, në procesverbalin për dorëzimin e dokumenteve, administruar nga Kolegji në cilësinë e provës.

11.3 Komisioneri Publik vëren se *shkresa me shkrim dore*, e referuar në shkaqet e ankimit të datës 31.10.2023, si dhe e cituar nga subjekti në prapësimet e tij, rezulton e administruar në dosje të Komisionit, në aktet e sjella nga vetë subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 6, gjatë hetimit administrativ.

⁹ Subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë shkak ankimi, gjatë parashtrimeve në seancën e datës 16.9.2024, ka paraqitur, në cilësinë e provës, Ekstrakt historik i regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit *** sh.p.k.

¹⁰ Referohuni analizës financiare në faqen 7 të rezultateve të hetimit administrativ, datë **.6.2023.

11.4 Nga aktet e sjella nga subjekti, rezulton se mbi bazën e materialeve të ardhurave nga Komisioneri i Policisë nr. 2, Tiranë, në datën **.11.2008, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor, Tiranë ka regjistruar *kallëzimin nr.****, që bën fjalë për veprën penale parashikuar nga neni 90 i Kodit Penal. Shtetasi ***. ***. ka bërë kallëzim ndaj shtetasit ***. ***, duke pretenduar se është goditur prej tij. Subjekti, me vendimin e datës **.12.2008, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin nr. **, të *viti 2008*.

11.5 Komisioneri Publik, nga aktet e administruara, vëren se marrëdhënia kontraktore e subjektit të rivlerësimit me shtetasin ***. ***, rezulton që daton më **.10.2011, me lidhjen e kontratës së shitblerjes së apartamentit me sip.71.2 m², Tiranë.

11.6 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, marrëdhënia e shitblerjes, e cila është nënshkruar në vitin 2011, në dukje nuk rezultoi të ketë rrethana për t'u trajtuar në kuptim të ekzistencës së kushteve për të pasur një trajtim preferencial sipas ligjit, apo për t'u *arsyetuar më tej mbi çështjen e konfliktit të interesit*.

12. Në përfundim, Komisioneri Publik, në zbatim dhe të Rekomandimit të ONM-së, vlerëson se rrethanat e lartpërmendura, që kanë rezultuar nga vlerësimi i pasurive të subjektit të rivlerësimit, duhen marrë në konsideratë në vlerësim tërësor të procedurave, sipas përcaktimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

C. Kërkimi përfundimtar

13. Komisioneri Publik, duke iu qëndruar shkaqeve të ankimit të datës 31.10.2023, mbështetur në sa më sipër trajtuar, bazuar në dispozitën e pikës 3 dhe 7, të nenit F, të aneksit të Kushtetutës, shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 66, pikës 2, të nenit 4, pikës 3, 4 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, kërkon nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 693, datë 10.8.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Saimir Hysa.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA